



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Kuvendi i Komunës - Gjakovë**

01 Nr. 011/01-266/h/2022

Dt. 26.10.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. Pika (d), nenit 40 pika (J) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 8 dhe 18 të Ligjit nr.04/L-010 Për Bashkëpunim Ndërkomunal, dhe në nenin 6 të Rregullores nr.2023-1334 të datës 18.12.2012, në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.10.2022, pas diskutimeve lidhur më pikën e 2-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për miratimin e Marrëveshjes për bashkëpunim Ndërkombëtar me Bashkinë e Shkodrës, Republika e Shqipërisë, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Marrëveshja për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Bashkisë së Shkodrës, Republika e Shqipërisë .
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është marrëveshja e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Bashkisë së Shkodrës Republika e Shqipërisë, e nënshkruar nga Kryetari i Komunës së Gjakovës dhe Kryetari i Bashkisë së Shkodrës .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

**4. Vendimi iu dërgohet:**

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal .
- Bashkisë së Shkodrës- Republika e Shqipërisë
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit




Arbëneshja Klauqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPUBLIKA  
E KOSOVË,  
BASHKIA SHKODËR



BASHKËPUNIMI  
MARRËVESHJE BASHKË

NDËRKOMBËTAR

NDËRMJET

BASHKISË SHKODËR

dhe

KOMUNËS GJAKOVË

me synim

NXITJEN E BASHKËPUNIMIT DYPALËSHE NË FUSHËN SOCIAL EKONOMIKE,

ARSIMIT, TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Sot me datë \_\_\_/\_\_\_/2022 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet:

BASHKIA SHKODËR me adresë Rr "13 Dhjetori" Shkodër, Shqipëri e përfaqësuar nga Kryetar  
z. Bardh Spahia.

Dhe

KOMUNA GJAKOVË me adresë Rruga "Nëna Tereze", Gjakovë, Kosovë, e përfaqësuar nga Kryetar z. Ardian Gjini.

Kjo marrëveshje nënshkruhet nga Bashkia Shkodër (më tej "Bashkia") dhe Komuna Gjakovë (më tej "Komuna"), këtu e tutje të referuara së bashku si "Palët".

Duke qenë se Palët:

Vlerësojnë rëndësinë e promovimit të territorit, përmes zhvillimit të aktiviteteve social ekonomike, arsimore, turizmit, kulturës dhe sportit.

Marrin ne konsideratë historinë e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndër viteve ndërmjet Shkodrës dhe Gjakovës në fusha të ndryshme të veprimtarive ekonomike, jetës artistike kulturore, turizmit dhe sportit.

Synojnë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet qyteteve me interes të përbashkët në fushën e zhvillimit social ekonomike, arsimit, turizmit, kulturës dhe sportit.

Konfirmojnë angazhimin institucional për të bashkëpunuar në fusha me interes të përbashkët për të rritur efektivitetin e përpjekjeve të tyre zhvillimore.

Palët së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si "Marrëveshja", si më poshtë vijon:

## BAZA LIGJORE

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar  
Ligji nr.03/L-040 "Për vetëqeverisjen Lokale"

### Neni I Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje bashkëpunimi është të sigurojë një mënyrë bashkëveprimi dhe të lehtësojë bashkëpunimin midis Palëve, mbi baza jo-përbashkë, në fusha me interes të përbashkët, në fushën social ekonomike, arsimit, turizmit, kulturës dhe sportit.

### Neni 11 Fushat e bashkëpunimit

2.1 Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme të veprimit:

- a. Promovimi i aktiviteteve social ekonomike dhe turizmit;
- b. Mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e burimeve natyrore dhe biodiversitetit;
- c. Bashkëpunim në hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta;

- d. Promovimi dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe sportive;
- e. Promovimi dhe zhvillimi i aktiviteteve edukative ndërkulturore dhe projekteve të rinjve dhe studentëve të Shkodrës dhe Gjakovës;
- f. Promovimi i aktiviteteve të parashikuara në këtë Marrëveshje;
- g. Takime të përbashkëta për të trajtuar çështje me interes të përbashkët.

#### Neni 111

#### Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit

- 3.1 Palët, të mbështetura në parimet bazë, do të mbajnë të informuar njëra-tjetrën dhe do të konsultohen për çështjet me interes të përbashkët, të cilat ka të ngjarë të ëojnë në bashkëpunim të ndërsjellë.
- 3.2 Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve sipas këtij Neni do të jetë pa cënuar Marrëveshjen, duke ruajtur karakterin konfidencial dhe të kufizuar të informacionit dhe dokumenteve të caktuara.
- 3.3 Palët, në kohë të ndryshme sipas nevojës, mund të kërkojnë për Cu mbledhur për të shqyrtuar mbarëvajtjen e aktiviteteve të zhvilluara sipas kësaj Marrëveshje dhe për të planifikuar aktivitetet e ardhshme.

#### Neni IV

#### Zbatimi i Marrëveshjes

- 4.1 Kjo marrëveshje pasqyron pikëpamjet dhe synimet e Palëve për të bashkëpunuar në baza jo ekskluzive, të shprehura në mirëbesim, por pa krijimin e ndonjë detyrimi ligjor ose kryerjen e ndonjë përgjegjësie nga ana e ndonjërës prej tyre.
- 4.2 Kjo Marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën, ose nuk do të pengojë Palët të hyjnë në Marrëveshje ose angazhime me palët e tjera në lidhje me ndonjë aktivitet, projekt ose fushë bashkëpunimi të mbuluar nga kjo Marrëveshje.
- 4.3 Palët do të jenë përgjegjëse për veprimet dhe lëshimet në lidhje me këtë marrëveshje dhe zbatimin e saj.
- 4.4 Marrëveshja e bashkëpunimit do të kryhet në përputhje me ligjet në fuqi të të dyja vendeve në bazë të detyrimeve përkatëse që merren nga të dy palët sipas të drejtës ndërkombëtare.
- 4.5 Marrëveshjet e lidhura nga Palët në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar janë vetëm të natyrës administrative dhe teknike.
- 4.6 Në kuadër të këtij bashkëpunimi ndërkombëtar, Palët nuk kanë të drejtë të heqin dorë nga kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj, për t'ia deleguar njëra tjetrës në ushtrimin e kompetencave të veta apo ti lejojnë palës tjetër ushtrimin e çfarëdo pushteti ekzekutiv, administrativ, legjislativ në territoret e të dy shteteve ose që synon të ketë efekt të tillë në territoret e të dy shteteve.

#### Neni V

## Burimet Financiare për Realizimin e Bashkëpunimit

Të dy palët pajtohen se çdo aktivitet që synon zbatimin e kësaj Marrëveshje nuk do të implikojë pagesa shtesë nga sistemi publik i financave, duke u bazuar në ligjin për financa publike në fuqi, por do të mbulohen nga institucionet e propozuara.

### Neni V1

#### Koordinimi Ndërmjet Palëve

Palët në këtë marrëveshje bien dakord për të formuar një grup të përbashkët, i cili është përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjes në fjalë, me persona kontakti për koordinimin e aktiviteteve në vijim.

### Neni VII

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7.1 Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

7.2 Palët kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në Marrëveshje me pëlqimin e ndërsjellët të tyre.

### Neni VIII

#### Dispozitat Përfundimtare

8.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj, dhe është e vlefshme për një afat kohor të pacaktuar.

8.2 Kjo Marrëveshje mund të plotësohet, ndryshohet dhe shkëputet me pëlqimin e ndërsjellët të tyre. Amandamenti do jetë pjesë integrale e marrëveshjes pas nënshkrimit.

8.3 Kjo Marrëveshje është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale, secila në gjuhën Shqipe ku palët nënshkruese marrin nga 2 (dy) kopje.

SI DËSHMI E KËSAJ, përfaqësuesit e autorizuar të Palëve nënshkruajnë më poshtë:

PËR BASHKINË E SHKODRËS  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Bardh Spahia**  
Kryetar i Shkodrës



PËR KOMUNËN E GJAKOVËS  
REPUBLIKA E KOSOVËS

**Ardian Gjini**  
Kryetari Gjakovës



*Ardian Gjini*

4